



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr.583/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtarja Shpresa Emra, në kontestin e paditësit P.T.K. i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Sami Thaqi nga Prizreni, kundër të paditurit A. M. nga Prizreni, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 138.00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.05.05.2014 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkespadija e paditësit PTK-Prishtinë dhe **OBLIGOHET** i padituri A. M. nga Prizreni që në emër të borxhit të ia pagujë paditësit shumën **prej 138.00€**, me kamatë vjetore prej 3.5 % duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit me dhunë.
- II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditurit.

A r s y e t i m

Pretendimete e palëve

Paditësi ka parashtruar propozim për përmbarrim kundër të paditurit A. M. nga Prizreni, pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur obligimet dhe nuk e ka paguar borxhin për shfrytëzimin e telefonisë fikse për muajt 1 dhe 2 të vitit 2004 në shumë të tërësishme prej 138,00€ në bazë të faturave dhe gjendjes së shfrytëzimit telefonit fiks .I padituri në procedurën përmbarrimore ka parashtruar kundërshtim dhe bazuar në ligj propozimi për përmbarrim konsiderohet si padi. I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor kryesisht ka ngelur pranë pohimeve të padisë dhe të kërkesëpadiës, në fjalën e fundit ka propozuar që gjykata të aprovoj të njëjtën si të bazuar dhe të obligoj të paditurin që të paguaj

borxhin në shumë të përgjithshme prej 138.50€ me kamatë ligjore si në propozim për ekzekutim si dhe që të paguaj shpenzimet procedurale sado që ato të jenë ato

I padituri ka dhënë përgjegje në padi duke e mohuar padinë dhe kërkesën nga padia dhe duke cekur se telefonin për të cilin kërkohet borxhi, ai që disa vite nuk e shfrytëzon dhe e konteston faktin që ka shpenzuar shumën e kërkuar. Posta pa kurrfarë paralajmërimi ia ka marrë numrin, nuk i ka dërguar ndonjë vërejtje se në rast të mospagesës së borxhit do t'i mirret numri në mënyrë që ai të veprojnë sipas kësaj vërejtjeje. Konsideron se kërkesa është vjetërsuar dhe se borxhi i vitit 2004 kërkohet pas 10 viteve. Gjithashtu ka cekur se është pensioner me gjendje të vështirë ekonomike dhe nuk ka mundësi të paguaj borxhin që i është ngarkuar dhe fare pa e shfrytëzuar. Ka propozuar që të refuzohet kërkesë padia e paditësit.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë shiqimin në faturat e PTK në Prizren për muajin 01.2004 dhe 02.2004 në bazë të së cilëve vërtetohet se borxhi për muajin janar ka qenë 94,50€ dhe për muajin shkurt ka qenë 44,00€, gjithësejt 138.00€.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkespadia e paditësit është BAZUAR.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykata vërtetoi gjendjen faktike si vijon - nuk është kontestuese se i padituri e ka shfrytëzuar telefonin dhe shërbimet e telefonisë së paditësit. Nuk është kontestuese se për të njëjtat edhe ka fatura të parashtruara nga ana e paditësit. Paditësi me propozim, padi dhe fjalën përfundimtare ka kërkuar kompensimin për muajt 1 dhe 2 të vitit 2004 në shumë të tërësishme prej 138,00€ të cilin fakt e ka kontestuar i padituri duke u thirrur në parashkrim të borxhit në afat prej një viti , por nuk e ka kontestuar se ka shfrytëzuar shërbimet e telefonisë fikse dhe numrin e lartcekur. Gjykata ka vlerësuar se faturat e lëshuara nga ana e paditësit janë dokumente publike, zyrtare dhe të obligueshme për konsumatorë të cilët shfrytëzojnë shërbimet e paditësit andaj bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), respektivisht në nenin 17 ku ceket se **“pjesëmarrësit e detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”**, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se **“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”**, andaj nga këto arsye u vendos si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.583/2012 të dt.05.05.2014

Gjyqtarja
Shpresa Emra

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.